



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:079415

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05403019

C.nr. 298/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.K nga fshati Pastasel, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson avokati R.H nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të E me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar F.H, me bazë juridike kompensimin e dëmit material, vlera objektit të kontestit 2,209.40 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, më datën 20.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRSI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit S.K nga fshati Pastasel, Komuna e Rahovecit.

II. DETYROHET e paditura E me seli në Prishtinë, që paditësit S.K, në emër të dëmit material të shkaktuar në veturën “M”, në aksidentin e trafikut të datës 22.12.2022, në Rahovec, t’ia kompensojë shumën prej 2,209.40 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 12.04.2021 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura E me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve procedurale, paditësit S.K të ja paguajë shumën prej 544.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi S.K nga fshati Pastasel, Komuna e Rahovecit, më datën 12.04.2021, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në këtë gjykatë ndaj të paditurës E me seli në Prishtinë, ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material, në shumën prej 2,209.40 euro, e cila shumë është precizuar në seancën e datës 20.02.2024.

I autorizuari i paditësit në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë, është e vërtetë se me datë 22.12.2020 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit ku përgjegjës për dëmin material që i është shkaktuar paditësit ka qenë i siguruari i të paditurës, siç shihet edhe nga raporti i policisë dhe shkresat tjera që i janë paraqitur kësaj lënde. Më tej ka shtuar se e paditura i ka ofruar një ofertë por oferta që

i ka ofruar është tejet e ulët në krahasim me dëmet që i janë shkaktuar në automjetin e tipit M. Gjykatës i ka propozuar që të nxirret prova me ekspertizë nga lëmi i makinerisë, i cili do të ketë për detyrë që të bëjë vlerësimin e dëmit për pjesët e dëmtuara të automjetit i cili është objekt i kësaj çështje kontestimore. Pas pranimit të ekspertizës ka deklaruar se ndaj ekspertizën e makinerisë nuk ka vërejtje, ndërsa për ekspertin nuk ka pyetje. Gjykatës i propozoi që pas shqyrtimit të provave kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar F.H, në përgjigjen në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbeten në tërësi si në përgjigjen në padi, duke shtuar se për të paditurën nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë por vetëm lartësia e saj. Sa i përket propozimit të të autorizuarit të paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i makinerisë nuk e kundërshtoi. Pas pranimit të ekspertizës ka theksuar se kanë vërejtje sa i përket lartësisë, ndërsa për ekspertin nuk ka pyetje. Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë pjesërisht si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 20.02.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: raportin policor me nr. 2020-ER-588, i datës 22.12.2020, i përpiluar nga Stacioni Policor Gjakovë; ankesën e dorëzuar tek e paditura, nga paditësi, me datë 27.01.2021; certifikatën e regjistrimit të automjetit, të paditësit S.K, për automjetin me nr. identifikues të automjetit W.... dhe nr. të regjistrimit targa..., si dhe ekspertizën e makinerisë, e punuar nga eksperti i makinerisë B.K dhe e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 29.11.2023.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datën 22.12.2020 rreth orës 18:45, në Rahovec është shkaktuar aksidenti i trafikut, në të cilin aksident pala paditëse ka pësuar dëm në automjetin e tij të markës “M”, me targa të regjistrimit KS..., si pasojë e goditjes nga vetura e markës “A”, me targa të regjistrimit 07..., e siguruar tek e paditura. Ky fakt është vërtetuar edhe nga raporti policor me nr. 2020-ER-588, i datës 22.12.2020, i përpiluar nga Stacioni Policor në Gjakovë. Po ashtu nuk ishte kontestues as fakti se vetura e cila ka shkaktuar aksidentin e trafiku ka qenë e siguruar tek e paditura. Për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese as baza juridike e kërkesëpadisë, ndërsa kontestuese ishte lartësia e dëmit material të shkaktuar.

Me administrimin e ekspertizës lidhur me vlerësimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar, të ekspertit B.K, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 29.11.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se ekspertiza në bazë të fotografive të automjetit të dëmtuar, çmimit të pjesëve të automjetit, çmimit për riparim, hulumtimeve në internet, në bazë të katalogut dhe faturave, ka konstatuar se dëmi i shkaktuar në

veturën e markës “M”, me targa të regjistrimit KS..., pronë e paditësit është në lartësi prej 2,209.40 euro. Gjykata ekspertizën vlerëson të hartuar dhe argumentuar mirë dhe në mënyrë profesionale, pasi që i njëjti mendim është dhënë duke u bazuar në shkresat e lëndës, andaj të njëjtën e pranoj të besueshëm dhe të njëjtës ia fali besimin në plotësi.

Gjykata vendosi ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për faktin se sipas vlerësimit të saj, në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit material si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ku ky aksident është shkaktuar si rezultat i lëshimeve të të siguruarit të të paditurës, e që nuk është kontestuar edhe nga e njëjta. Baza juridike e kërkesëpadisë buron nga neni 136 i LMD-së, ku parashihet se *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa neni 140 i të njëjtit ligj parasheh se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Po ashtu, në nenin 159 par. 1 të LMD-së *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”*.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur që ta aprovojë në tërësi shumën prej 2,204.40 euro, të cilën përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e ka precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.02.2024, për faktin se në aksidentin e datës 22.12.2020, paditësit i është shkaktuar ky dëm në veturën e tij. Fakt vendimtar që gjykata ka vendosur që ta aprovojë në tërësi lartësinë e precizuar të kërkesëpadisë së paditësit ka qenë ekspertiza e makinerisë e punuar nga eksperti i makinerisë, B.K, sipas të cilës, vetura e paditësit e kishte të dëmtuar mbrojtësin e pasmë në tërësi, vlera e të cilit ishte 1,200.00 euro, dritën e pasme të majtë, vlera e të cilit ishte 220.00 euro, duke përfshirë shumën prej 200.00 euro për materiale konsumi për lyerje, 540.00 euro për orët e punës për çmontimin dhe montimin e pjesëve si dhe ngjyrosjen dhe riparimin e veturës, shumën prej 29.40 euro për material përcjellës prej 2% si dhe material për riparime të rrjetit elektrik në shumën paushallë prej 20.00 euro. Ky vlerësim është bërë në harmoni me çmimin e tregut të pjesëve të veturës si dhe çmimit për riparim të katalogut “Quattrooruote”, e që për gjykatën është bazë e qartë se lartësia e caktuar nga ekspertiza e makinerisë është shuma që duhet t’i kompensohet paditësit. Në lidhje me vendosjen sa i përket lartësisë së dëmit, gjykata pati parasysh edhe dispozitën e nenit 174 të LMD-së, sipas të cilës *“Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”*.

Sa i përket vërejtjeve të të paditurës se lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë e që është konstatuar me ekspertizën e ekspertit B.K, kjo gjykatë vlerëson se këto kundërshtime nuk qëndrojnë dhe janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata. E njëjta me asnjë provë nuk ka arritur ta vërtetojë të kundërtën nga ajo që është kontestuar nga ekspertiza e ekspertit të makinerisë.

Prandaj, gjykata gjatë procedurës bëri vlerësimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse në arsyetimin e aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar në marrjen e vendimit si më lartë, duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së, i cili

përcakton se “*Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore*”, për çka ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136 par. 1, nenit 174 si dhe nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që i padituri t’ia kompensojë paditësit shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që i referohen përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro, taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, për përfaqësim në dy seanca shumën prej 270.80 euro, si dhe për ekspertizën e makinerisë shumën prej 150.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 544.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.298/2021, më datë 20.02.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.